

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 454 Prot.

Tiranë, më 26.04 2016

VENDIM Nr. 29, datë 22.04.2016

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë"(i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.5 të datës 22.04.2016, pasi shqyrtoi *Relacionin mbi Vëzhgimin gjeoteknik dhe studimin e tokës në zonën e parashikuar për ndërtimin e Stacionit të Kompresimit ACS03 Fier, propozimin për kryerjen e sondimeve gjeologjike në këtë zonë*, paraqitur nga Kompania "Dega Renco s.p.a"sh.p.k dhe *relacionin e verifikimit të terrenit nga pikpamja arkeologjike, në kuadër të projektit "TAP"*, paraqitur nga shoqëri e licencuar në arkeologji "ABKONS"sh.p.k.,

VENDOSI:

1. Të miratojë *Relacionin mbi Vëzhgimin gjeoteknik dhe studimin e tokës në zonën e parashikuar për ndërtimin e Stacionit të Kompresimit ACS03 Fier, propozimin për kryerjen e sondimeve gjeologjike në këtë zonë* paraqitur nga Kompania "Dega Renco s.p.a"sh.p.k dhe *relacionin e verifikimit të terrenit nga pikpamja arkeologjike, në kuadër të projektit "TAP"*, paraqitur nga shoqëri e licencuar në arkeologji "ABKONS" sh.p.k.
2. Raporti i sondimeve gjeologjike të paraqitet në KKA e radhës.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI
MINISTËR



SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO